



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
Ministri

Nr. 1289 Prot.

Tiranë, më 25/02/2010

UDHËZIM

Nr. 7 datë 25.02.2010

PËR
PËRFUNDIMIN E VITIT SHKOLLOR 2009-2010 DHE
PËR ZHVILLIMIN E PROVIMEVE TË LIRIMIT NË SISTEMIN E ARSIMIT
PARAUNIVERSITAR

Në bazë të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 7952, datë 21.06.1995 "Për Sistemin Arsimit Parauniversitar" i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

KREU I

PËRFUNDIMI I KLASËS IX TË ARSIMIT BAZË

1. Viti mësimor 2009 - 2010, për klasën e IX të arsimit bazë të përfundojë në datën 01 qershor 2010 dhe të llogaritet me 34 javë mësimore.
2. Provimet e Lirimit për klasën IX të zhvillohen më:

- | | |
|-----------------|-----------------|
| a. Gjuhë Shqipe | 07 qershor 2010 |
| b. Matematikë | 19 qershor 2010 |

KREU II

DATAT PËR SESIONIN E DYTË TË PROVIMEVE TË LIRIMIT

1. Lëndët dhe datat e provimeve të lirimit në sesionin e dytë për nxënësit mbetës janë:

a. Gjuhë Shqipe dhe Lexim Letrar	01 shtator 2010
b. Matematikë	06 shtator 2010

KREU III

MASA PËR MBARËVAJTJEN E PROVIMEVE

1. Drejtoritë Arsimore Rajonale, Zyrat Arsimore dhe Drejtoritë e shkollave të marrin të gjitha masat që viti mësimor 2009-2010, për klasat e nënta të mbyllet sipas programit dhe me nota përfundimtare për çdo lëndë brenda datës **02 qershor 2010**, duke shfrytëzuar orët në dispozicion.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi nr. 31, datë 31.08. 2009, të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës "Për zbatimin e planeve, programeve dhe teksteve mësimore të arsimit parauniversitar në vitin shkollor 2009-2010", në lidhje me përfundimin e vitit shkollor 2009-2010, për klasat e 9 të arsimit bazë dhe në lidhje me zhvillimin e Provimeve të Lirimit për sesionin e parë revokohet.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Zëvendësministri që mbulon arsimin parauniversitar, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Edukimit Parauniversitar, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Agjencia Qendrore e Vlerësimit të Arritjeve të Nxënësve, Drejtoritë Arsimore Rajonale dhe Zyrat Arsimore.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren Zyrtare"

MYQEREM TAJ

MINISTËR